


# Trajnim për Shërbesa e Sporteve



## Trajnim

### Sesioni 1: Ungjillizimi - Pse dhe Si

#### 1) Pse të Ungjillizojmë?

- **Porosia e Madhe**

📖 Gjoni 3: 16

Perëndia na do kaq shumë sa e dërgoi Jezusin në këtë tokë për të na shpëtuar dhe nëse do të besojmë në Të do të kemi jetë të përjetshme. Dëshira e Perëndisë është që njerëzit ta ndjekin dhe të jetojnë me Të përgjithmonë. Si të krishterë, Ai na kërkon ta ndihmojmë në këtë gjë.

📖 Mat 28: 16-20 dhe Luka 24: 45-49

Jezusi na thërret të shkojmë jashtë dhe ta ndajmë Ungjillin kudo që shkojmë. Ai do të na japë forcën dhe kurajon për ta bërë këtë gjë.

#### 2) Shpjegimi i Ungjillit

Ne duhet të jemi \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ !

- **Rruga e Romakëve**

📖 Mbjaj mend 4 vargje nga Romakët. Përdori ato për të shpjeguar Ungjillin.

Shkruani vargjet në rreshtat e mëposhtëm. Kjo do tju ndihmojë ti mbani mend më lehtë.

Romakët 3: 23 \_\_\_\_\_

Romakët 6: 23 \_\_\_\_\_

Romakët 5:8 \_\_\_\_\_

Romakët 10: 9,10 \_\_\_\_\_

- **Katër Ligjet Shpirtërore**

##### 1) Ligji i Parë

Perëndia të do dhe të ofron një plan të mrekullueshëm për jetën tënde.

##### 2) Ligji i Dytë

Njeriu është mëkatar dhe i ndarë nga Perëndia. Prandaj ai nuk mund ta dijë dhe ta përjetojë dashurinë dhe planin e Perëndisë për jetën e tij.

##### 3) Ligji i Tretë

Jezus Krishti është masa që mori Perëndia për mëkatin e njeriut. Nëpërmjet Tij ti mund ta mësosh dhe ta përjetosh dashurinë dhe planin e Perëndisë për jetën tënde.

Nuk mjafton vetëm ti dish këto 3 ligje....

##### 4) Ligji i Katërt

Ne duhet personalisht ta pranojmë Jezus Krishtin si Zot dhe Shpëtimtar dhe atëherë ne mund të dimë dhe të përjetojmë dashurinë dhe planin e Perëndisë për jetën tonë.

- **Pyetja për Parajsën**

Kur të bisedoni me dikë, ju mund ti bëni pyetjen e mëposhtme:

---

---

- **Topi i Ungjillit**

Ky top ka disa ngjyra. Çdo ngjyrë nga një kuptim të veçantë. Ju mund ti përdorni ngjyrat e topit ungjillizues për të shpjeguar Ungjillin.

Jeshile \_\_\_\_\_

e Zezë \_\_\_\_\_

e Kuqe \_\_\_\_\_

e Bardhë \_\_\_\_\_

Blu \_\_\_\_\_

e Artë \_\_\_\_\_

- **Mbaj Mend**



Zoti dëshiron që njerëzit të shpëtohen. Ne mund ta ndihmojmë duke iu shpjeguar Ungjillin njerëzve që takojmë me guxim dhe në mënyrë të qartë.

**Gjoni 3:16** - Sepse Perëndia e deshi aq botën, sa dha Birin e Tij të vetëmlindur që kushdo që beson në të, të mos humbasë por të ketë jetë të përjetshme.

## Trajnim

### Sesioni 2: Përdorimi i Aktiviteteve Sportive për të arritur të tjerët për Krishtin

#### 1) Parimet Biblike për Shërbesën e Sporteve

- \_\_\_\_\_  
Zoti është i shumëllojshëm në natyrën dhe veprat e Tij. Ai vepron në mënyra në ndryshme
- \_\_\_\_\_  
 1 Kor 12: 4-6  
Perëndia i ka dhënë secilit prej nesh dhunti të ndryshme. Ai kënaqet kur ne i përdorim dhuntitë tona për ti shërbyer Atij.
- \_\_\_\_\_  
 1 kor 9: 19-22  
Ne kemi lirinë për të përdorur mënyra të ndryshme për ti arritur të tjerët.
- \_\_\_\_\_  
Është zgjuarsia të përdorni mënyra krijuese dhe të përshtatshme për të ndarë Ungjillin.
- \_\_\_\_\_  
Bibla nuk thotë: mos i merrni parasysh aktivitetet sportive. 1 Tim 4:8 thotë: “ushtrimi trupit është i dobishëm për pak gjë....”.

#### 2) Shërbesa e Sporteve dhe kisha juaj

Misioni i kishës është si më poshtë:

 i drejtuar lart \_\_\_\_\_ (adhurimi)

\_\_\_\_\_

 i brendshëm \_\_\_\_\_ (inkurajimi)

\_\_\_\_\_

 i jashtëm \_\_\_\_\_ (ungjillizimi)

\_\_\_\_\_

#### 3) Si mund të përdorim aktivitetet sportive për të arritur të tjerët?

Si një skuadër ju shkoni rregullisht në fushat sportive stërviteni dhe luani me adoleshentët. Gjatë pushimit ndani Ungjillin me anë të një pantonimi ose dëshmie personale. Programi juaj mund të jëtë i tillë:

18:00 - 18:45 \_\_\_\_\_

18:45 - 19:00 \_\_\_\_\_

19:00 - 20:00 \_\_\_\_\_

#### Mbani mend

Perëndia e krijoi sportin dhe unë mund ta përdor për ta adhuruar Atë, për ti inkurajuar bashkëbesimtarët e mi dhe për ungjillizuar të rinj të tjerë.

**1 Kor 9: 22b** - “ E kam bërë veten time gjithçka për të gjithë, që të mund të shpëtoj me çdo mënyrë disa njerëz”.

## Trajnim - Sesioni 3: Organizimi i një Trajnimi për Aktivitetet Sportive

### Materialet:

- Dërrasë të bardhë dhe labustilë (markers)
- Topi i Ungjillit

### Qëllimi:

Pjesmarrësit do të mësojnë se çfarë nevojitet për të organizuar një Aktivitet Sportiv ungjillizues dhe do të ndihmohen për fazën e përgatitjes. Ky sesion duhet të bëhet para takimit të parë të ugjillizimit. Ky sesion zgjat dy orë. Nëse është e nevojshme mund të ndahet në dy pjesë, pjesa teorike dhe ajo praktike. Përgatitja praktike e mund të bëhet përpara ungjillizimit.

<p>🕒 15 min</p>	<p>① <b>Hyrja</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Reflektim për javën e kaluar</li> <li>• Mësimi për sot ka të bëjë organizimin e aktivitetit sportiv ungjillizues</li> </ul>										
<p>🕒 10 min</p>	<p>👁️ <b>Pjesa Vizuale</b> Trego pjesë nga video-ja rreth aktivitetit: “Duke dhënë Flakën”</p>										
<p>🕒 5 min ➔ shkruaji përgjigjet në dërrasë</p>	<p>❓ <b>Pyetja për Nxemje</b> Çfarë lloj aktivitetesh keni organizuar në kishë tuaj? Nëse grupi juaj nuk ka organizuar asnjë aktivitet, kërkojuni atyre të flasin për eksperiencën e tyre në lidhje me sportet.</p>										
<p>🕒 40 min</p> <p>Pershtate programin sipas organizimit</p>	<p>☺️ <b>Orgaizimi i Aktivitetit Sportiv Ungjillizues</b></p> <p>1) <b>Përgatisni një Program të Përgjithshëm</b></p> <table border="0"> <tr> <td>17:00 - 17:15</td> <td>Hyrja dhe Ushtrime të Nxemjes</td> </tr> <tr> <td>17:15 - 18:00</td> <td>Trajnimi</td> </tr> <tr> <td>18:00 - 18:15</td> <td>Pushimi me një pantonim ose dëshmi</td> </tr> <tr> <td>18:15 - 19:00</td> <td>Lojra</td> </tr> <tr> <td>19:00 - 19:15</td> <td>Bisedime dhe mbyllja</td> </tr> </table>	17:00 - 17:15	Hyrja dhe Ushtrime të Nxemjes	17:15 - 18:00	Trajnimi	18:00 - 18:15	Pushimi me një pantonim ose dëshmi	18:15 - 19:00	Lojra	19:00 - 19:15	Bisedime dhe mbyllja
17:00 - 17:15	Hyrja dhe Ushtrime të Nxemjes										
17:15 - 18:00	Trajnimi										
18:00 - 18:15	Pushimi me një pantonim ose dëshmi										
18:15 - 19:00	Lojra										
19:00 - 19:15	Bisedime dhe mbyllja										
<p>Së pari shpjego të gjitha pjesët e programit (nr 2-7) Pastaj trego se kush do të bëjë çfarë.</p>	<p>2) <b>Hyrja</b> Ndani pikat e mëposhtme:</p> <table border="0"> <tr> <td>- Kush jeni?</td> <td>Tregoni emrin tuaj dhe emrin e kishës ose organizatës suaj</td> </tr> <tr> <td>- Pse keni ardhur?</td> <td>Për të kaluar një kohë të mirë së bashku, jepuni një rast për të përmisuar aftësitë e tyre dhe bëni lojra për të ndarë mesazhin jetëndryshues.</td> </tr> <tr> <td>- Cilat janë pasionet e tua?</td> <td>Jezusi dhe Sporti</td> </tr> <tr> <td>- Ji Entuziast</td> <td>Motivoji për të qënë sportistë më të mirë</td> </tr> </table> <p>Pas kësaj pjese, kërkojuni pjesmarrësve të luajnë lojëra si (basketboll, vole volejball, kërcim në rrugë). Le të zgjedhin vetë dhe të ngrejne dorën se ku duan të shkojnë dhe drejtoji ku të shkojnë dhe tek kush.</p>	- Kush jeni?	Tregoni emrin tuaj dhe emrin e kishës ose organizatës suaj	- Pse keni ardhur?	Për të kaluar një kohë të mirë së bashku, jepuni një rast për të përmisuar aftësitë e tyre dhe bëni lojra për të ndarë mesazhin jetëndryshues.	- Cilat janë pasionet e tua?	Jezusi dhe Sporti	- Ji Entuziast	Motivoji për të qënë sportistë më të mirë		
- Kush jeni?	Tregoni emrin tuaj dhe emrin e kishës ose organizatës suaj										
- Pse keni ardhur?	Për të kaluar një kohë të mirë së bashku, jepuni një rast për të përmisuar aftësitë e tyre dhe bëni lojra për të ndarë mesazhin jetëndryshues.										
- Cilat janë pasionet e tua?	Jezusi dhe Sporti										
- Ji Entuziast	Motivoji për të qënë sportistë më të mirë										
<p>Një vakt i mirë përmban një meze si fillim, ushqim të mirë dhe një ëmbëlsirë. Çdo pjesë e ushqimit është përgatitur me kujdes dhe me përbërës të nevojshëm për të patur një shije të mirë. Së bashku me një shërbim të mirë dhe me një ambient të ngrohtë, ky vakt do të jetë një eksperiencë gatimi mbreslënëse. Po kështu, një aktivitet sportiv i mirë është i përbërë nga tre pjesë: <b>nxemja, trajnimi dhe lojrat</b>. Këto janë shumë të rëndësishme. Së bashku me një ambient të ngrohtë, materiale cilësore dhe entuziazëm, tranierë të motivuar, ky aktivitet do të jetë një eksperiencë sportive mbreslënëse.</p>											

Lejoji pjesmarrësit të zgjedhin llojin e nxjemes dhe të sportit që duan të shkojnë.

Mbaj shënim emrat e pjesmarrësve dhe adresën dhe numrat e telefonit.

⌚ 60 min

Mbaj shënim se kush është përgjegjës për çfarë.

### 3) Nxehmja

Bëni aktivitete argëtuese për nxehmje me të gjithë grupin (Aktivitete akullthuese). Pastaj, ndajeni grupin nëpër grupe të sipas sportve dhe vazhdoni me ushtrimet e nxehmjes. Ide për nxehmjën nëpër grupe:

- *Ski në borë*: Po bëj ski në borë, po bëj ski në borë. duart jashtë, duart brenda, gjunjët bashkë, këmbët bashkë, belin rrotullo, sytë jashtë, gjuha jashtë.
- *Peshkaqeni I vogël*

### 4) Trajnimi

- Njihni njeri-tjetrin!

Nëse nuk I njihni adoleshentët që kanë ardhur, mirepritini, pyeti për emrat ose luani një lojë për të mësuar emrat e tyre. për shembull, grupi është vendosur në një rreth dhe i hedhin njëri-tjetrit topin. Ai që e kap topin, do të thotë emrin e vet. Pas kësaj, përsëri grupi i hedh njëri –tjetrit topin, por kësaj radhe, ai që e ka topin, kur e hedh topin thotë emrin e atij që po ia hedh.

- Vazhdoni Nxehmjën

Vazhdoni të bëni disa ushtrime për nxehmje që I përshtatet llojit të sportit që keni zgjedhur. Bëjini argëtuese ushtrimet e nxehmjes: mos bëni vetëm vrap në rreth por gjithashtu edhe pak shtriqje muskujsh (streçing). Shikoi manualin për ide.

- Trajnimi I aftësive.

Organizo ushtrime të ndryshme për të përmisuar aftësitë e tyre sportive. Jini krijues! Mos i zgjasni ushtrimet për një kohë të gjatë. Bëni komplimente atyre që i bëjnë ushtrimet mirë ose që përpiqen shumë. Korrigjoni kur nuk I bëjnë ashtu siç duhet.

### 5) Pushimi

Mblidhni të gjithë grupin mes të fushës. Bëjeni këtë gjë shpejt sepse disa nga adoleshentët mund të largohen. Bëni një pantonim menjëherë në fillim dhe dikush të japë dëshminë e vet. Gjithashtu ky person për një minutë mund të shpjegojë kuptimin e pantonimës. Një ide tjetër është shpjegimi I Ungjillit me anë të urës së Topit të Ungjillit.

Për pak kohë pini diçka dhe bisedoni me adoleshentët. Pyetini se çfarë mendojnë për pantonimin/dëshminë

Kujdesuni që çdo person do të jetë I përgjegjshëm për të gjitha detyrat e veta. Parandaloni çrregullsinë.

### 6) Lojërat

Çdo person kthehet tek fusha e sportit. Formo grupet të reja dhe bëj lojëra me konkurrencë. (ju mund të jepni një çmim të vogël (psh çokollata të vogla) skuadrës fituese ose personit që ishte lojtari më pozitiv)

### 7) Mbyllja

Mblidhni grupin dhe falenderojini për ardhjen. Thuajini se kur do të ktheheni. Kaloni kohë duke biseduar me adoleshentët.

### Përgatitja e Aktivitetit

Kaloni kohë për tu përgatitur një aktivitet me ata që do të marrin pjesë. Nxitini ata për të dhënë idetë e tyre lidhur me ushtrimet. Jepni shembuj. Ata mund të drejtojnë nxehmjën, “lojën e emrave”, të shpjegojnë një ushtrim ose të japin një shembull sesi të bëjnë një ushtrim të caktuar, të bëjnë një pantonim ose dramë, të bëjnë një kërcim, ose të japin dëshminë e tyre ose të shpjegojnë ungjillin (psh duke përdorur topin e Ungjillit).

### Vajtja në fushë (për tranierin)

Kur të shkoni në fushë për aktivitetin sigurohuni ta keni gjithçka që ju nevojitet me vete. Tek Shtojca 1, do të keni në shembull të programit që mund ta përdorni dhe një listë për materialet që ju nevojiten.

### Vlerësimi

Jepuni secilit nga pjesmarrësit në formular për ta plotësuar kur të kthehen në shtëpi pas aktivitetit ungjillizues. Në fillim të sesionit tjetër, kaloni kohë për të vlerësuar sesi shkuan gjërat. Përdorni formularin e vlerësimit tek Shtojca 2.

**Trajnimi - Sesi 3: Organizimi I një aktiviteti sportiv Ungjillizues**

Shtatë hapa që çojnë në suksesin e aktivitetit sportiv

**1) Përgatit një Program të Përgjithshëm**

_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

**2) Hyrja**

Kush?

\_\_\_\_\_

Ndani detyrat e mëposhtme:

- Kush jeni?
- Pse keni ardhur?

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

- Cilat janë pasionet e tua?
- Ji entuziast

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Pyetini se cilin sport duan të shkojnë. Tregojni pjesmarrësve se kush është drejtuesi i tyre.

Sporti

Drejtuesi

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**3) Nxehmja**

Kush?

\_\_\_\_\_

Bëjeni argëtues aktivitetin e nxehmjes për të gjithë grupin. Pas kësaj ndajini nëpër grupe sipas sporteve që kanë zgjedhur dhe vazhdoni me ushtrimet e nxehmjes.

Ide për nxehmjen e grupit :

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

#### 4) Trajnimi

- \_\_\_\_\_  
Mësoni emrat e të tjerëve

- \_\_\_\_\_  
Bëni disa ushtrime argëtuese dhe shtriqje muskujsh (streçing)

- \_\_\_\_\_  
Bëni ushtrime të ndryshme për të përmisuar aftësitë sportive

#### 5) Pushimi

Mblidhni shpejt grupin në një vend të caktuar

Aktiviteti	Kush?
_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

#### 6) Lojërat

Kthehuni tek fusha e sportit. Formoni grupet të reja dhe bëj lojëra me konkurrencë. (ju mund të jepni një çmim të vogël (psh çokollata të vogla) skuadrës fituese ose personit që ishte lojtari më pozitiv).

#### 7) Mbyllja

Kush? \_\_\_\_\_

Mblidheni grupin dhe falenderojini për ardhjen. Thuajini se kur do të ktheheni. Bisedoni me adoleshentët.



## Trajnimi - Sesi 4: Drama

### Materialet:

- Dërrasë e bardhë dhe Labustikë (marker)
- Materiale për ushtrime dhe pantonime

### Qëllimi:

Pjesëmarrësit do të kuptojnë pse drama është një mënyrë efektive për të ndarë Ungjillin. Ata do të mësojnë sesi të shprehen lirshëm dhe të luajnë një pantonim.

<p>⌚ 5 min</p>	<p>① <b>Hyrja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Reflektim për javën e kaluar</li> <li>• Mësimi për sot do të fokusohet sesi të përdorim dramën dhe pantonimet për të ndarë besimin tuaj.</li> </ul>
<p>⌚ 10 min</p>	<p>👁️ <b>Pjesa Vizuale</b></p> <p>Shfaq dy pantonime nga DVD (“Sikur të isha në skenë” dhe “Karrigja”). Gjithashtu mund të luani një pantonim para grupit.</p>
<p>⌚ 5 min Shkruani në dërrasë të gjitha përgjigjet. Ata do ti kthehen përsëri gjatë mësimit.</p>	<p>❓ <b>Pyetje për Nxehmje</b></p> <p>Pse mendoni se drama është një mënyrë e mirë për ndarë Ungjillin?</p>
<p>⌚ 15 min Pjesëmarrësit mbushin hapësirat bosh në fletat që ju janë dhënë.</p>	<p>📖 <b>Mësimi</b></p> <p><i>Pse Drama?</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drama ofron një shfaqje vizuale që i ndihmon njerëzit të mbajnë mend më gjatë . Ne po jetojmë në botën e komunikimit vizual.</li> <li>• Drama lejon mundësinë për më shumë krijimtari për të nxjerrë kuptimin e asaj që duam të themi. Bibla është plot me ekspresivitet dhe krijimtari. Vetë Jezusi përdori krijimtarinë për ti ungjillizuar turmat që e rrethonin. Këto ishin “audio-drama”- drama në formën e tregimeve. Këto tregime thuheshin të përputhje me kontekstin kur degjuesit jetonin. Psh Jezusi përdori fjalë si dele, vresht, at &amp; bir etj. Në këtë mënyrë Ungjilli bëhet më tërheqës dhe më i lehtë për tu komunikuar audiencës.</li> </ul> <div style="border: 1px solid black; padding: 5px; margin: 10px 0;"> <p>Në kohën e kishës mesjetare, kisha u mbështet shumë tek imazhet dhe dramën për të arritur shoqërinë kur shumica nuk dinte të lexonte. Boniface (Winfred), një peshkop misionar Katolik i hershëm në Gjermani, mbledhi një turmë të madhe të adhuruesve pagan në Gelshmar, ku ndodhej lisi i shenjtë i perëndisë së Bubullimës. Njerëzit shikonin të tmerruar ndërsa ai filloi ta priste lisin. Ishte një akt provokues por një akt i tillë u tërhoqi vëmendjen tek Perëndia Sovran. Për shkak të aktit të Bonifaces, mijëra njerëz njohën Zotin kur mesazhi u predikua. Drama është një komunikim efektiv për të arritur audiencën që kundërshton.</p> </div> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Disa njerëz kanë dhunti që luajnë sporte të ndryshme. Të tjerë kanë dhunti të luajnë drama. Në këtë mënyrë ne mund ti përdorim të gjitha dhuntitë tona dhe talentet për ti ungjillizuar të tjerët.</li> </ul> <p><i>Disa ndihmë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Audiencia duhet të ketë mundësi tju shikoj. Asnjëherë mos luani me kurriz nga audiencia. Njerëzit duhet të jenë në gjendje të shikojnë fytyrat tuaja.</li> <li>• Përqëndrohuni në personazhin që do të luani Përfshihuni në personazhin që kenë. Ju duhet të luani me vërtetësi.</li> <li>• Ekzagjerojeni. Ekzagjerojeni shprehjet e fytyrës dhe të lëvizjeve që bëni.</li> <li>• Krijoni kontakte Nëse është e mundur në ndonjë pjesë të dramës ose pantonimës, përpuni të krijoni kontakte me audiencën. Kështu ata do ta përjetojnë dramën më shumë.</li> <li>• Jini dinamik Kur luajnë më shumë se një person, bëjeni dramën dinamike. Risni dhe ulni shpejtësinë e ngjarjes.</li> </ul>

🕒 10 min

### 😊 **Praktika**

#### **Ushtrimet**

- Ushtrimi i përqëndrimit: Tregoni një histori që keni përjetuar javën e kaluar. Të tjerët ju shpërqëndrojnë sa më shumë të jetë e mundur duke ju bërë pyetje dhe duke ju bërë vërejtje. Vazhdoni të flisni dhe të jini të përqëndruar.
- Bëni një rreth dhe ashtu siç jeni, në të njëjtën kohë ose njëri pas tjetrit, me anë të fytyrës dhe trupit shprehni emocione të ndryshme si: kur je i zemëruar, i gëzuar, i frikësuar, i habitur, i dashuruar, i emocionuar, i zhgënjyer, krenar, i trishtuar, superior, inferior etj. Vështroni njëri-tjetrin emocionet duken të vërteta. Një metodë tjetër është kur një person të imitoj emocione të ndryshme dhe të tjerët mund ta gjejnë se çfarë emocioni është .
- Ndryshoni emocionin tuaj me ngadalë dhe kujdes psh: nga i frikësuar/i pasigurt në i sigurt/i lirë, nga i trishtuar në i gëzuar, nga inferior në superior, nga i emocionuar në i çliruar/ krenar etj. Të gjitha lëvizjet kalojnë nga emocione të vogla/ të brendëshme në të mëdha/shfaqura.

🕒 20 min

Jo të gjithë mund të ndihen rehat të luajnë në pantonim. Lëjini ta provojnë njëherë. Nëse nuk ndihen rehat, të tjerët mund ta bëjnë këtë gjë. Ne të gjithë kemi dhunti dhe talente të ndryshme!

#### **Pantonime**

Mësojini pjesmarrësve një pantonim që mund ta përdorin gjatë ungjillizit tjetër. Përdorni manualin e Dramave për të zgjedhur një pantonim.

## **PËRGJIGJET**

*Pse e përdorim dramën për të shpjeguar Ungjillin?*

- Drama ofron një shfaqje **vizuale** që i ndihmon njerëzit të mbajnë mend më gjatë .
- Drama lejon mundësinë për më shumë **krijimtari** për ti nxjerrë kuptimin e asaj që duam të themi.
- Drama na jep mundësi të **përdorim dhuntitë tona** dhe talentet për ti ungjillizuar të tjerët.

*Disa ndihmë:*

- **Audienca** duhet të ketë mundësi tju shikoj.
- **Përqëndrohuni** në personazhin që do të luani
- **Ekzagjeroni** shprehitët e fytyrës dhe të lëvizjeve që bëni.
- Përpiquni **të krijoni kontakte** me audiencën.
- Jini **dinamik**: Rrisni dhe ulni shpejtësinë e ngjarjes.

## Trajnim - Sesiioni 4: Drama

*Pse i përdorim dramën për të treguar Ungjillin?*

- Drama ofron \_\_\_\_\_ që njerëzit të mbajnë mend më gjatë.
- Drama lejon \_\_\_\_\_ për të nxjerrë kuptimin e asaj që duam të themi.
- Drama na jep mundësinë \_\_\_\_\_ për të arritur të tjerët.

*Pak ndihmë:*

- \_\_\_\_\_ duhet të jetë në gjendje tju shikoj.
- \_\_\_\_\_ në personazhin tuaj.
- \_\_\_\_\_ shprehjet e fytyrës dhe të lëvizjeve që bëni.
- Përpiquni të \_\_\_\_\_ me audiencën tuaj.
- Jini \_\_\_\_\_ : rrisni dhe ulni shpejtësinë e ngjarjes.